



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 808 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

DEKLARATË MJEDISORE

për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Në mbështetje të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, ministri lëshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

PLANIN LOKAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE PËR BASHKINË POGRADEC

Kërkuesi: Bashkia Pogradec

Kufijtë e zonës që mbulon plani: sipërfaqja në administrimin e bashkisë Pogradec dhe njësitë e saj administrative.

Përdorimi i deklaratës mjedisore:

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin, që për projekte të veçanta të parashikuara në këtë Plan, t'i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi.

Qëndrimi i ministrisë:

Plani i propozuar në parim përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutese, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e vleresimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas

miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatës.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit:

Gjatë zbatimit të projekteve/veprimeve për menaxhimin e mbetjeve, priten ndikime pozitive dhe negative. Ndikimet pozitive priten për përmirësimin e cilësisë së ujrave, tokës, ajrit dhe ndryshimet klimatike, si edhe për popullatën dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë ndikime mbi faktorët klimatikë duke konsideruar që mjetet e transportit për mbetjet dhe të gjitha fasilitetet e tjera, do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi zona ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturë për menaxhimin e mbetjeve. Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Ndikime negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe ndikimet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqëndrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave:

Objektivat e përcaktuara mjedisore janë në përputhje me Ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikën dhe projektet që parashikon Planin për të arritur objektivat e tij. Për të përcaktuar rëndësinë e objektivave mjedisore, është vlerësuar përputhshmëria e objektivave të Planit me objektivat e përcaktuara mjedisore. Vlerësimi i përputhshmërisë krijon konflikte apo veprime të ndërsjellta mes objektivave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara interesi mes objektivave; të gjitha këto duhen vënë në dukje veçanërisht në pjesën e vlerësimit të aktiviteteve specifike të Planit.

PLMM ka katër objektiva kryesore, të cilat në thelb janë në përputhje me objektivat e VSM . Pas njohjes me Planin deri në nivelin e projekteve specifike të propozuara, e vlerësuam si të arsyeshme që të konstatohej përputhshmëria e ndikimeve të projekteve në lidhje me arritjen e objektivave të Planit.

13 projekte priten që të kenë impakte përtej objektivave të Planit.

Objektivi 4 qëndron dobët në plan përse i takon projekteve specifike. Megjithatë, i marrë në nivelin emenaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel rajoni, ky objektivi ka vendin e vet dhe projektet specifike duhet të rakordohen me planin rajonal të menaxhimit të mbetjeve.

Në mënyrë të përmbledhur, sugjerojmë që krahas katër objektivave të pozicionuara në Plan, ky i fundit të parashohë edhe objektivat shtesë si më poshtë:

- Rehabilitimi i vend-depozitimeve ekzistuese të ligjshme dhe të paligjshme
- Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve, si dhe sigurimi i mundësive të reja të zhvillimit të biznesit;
- Zbatimi i skemave të kujdesit social dhe shëndetësor për grupet vulnerabël
- Arritja e objektivave për mbledhjen e fondeve së bashku me pjesëmarrjen dhe edukimin e publikut;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar;

Gjithashtu, sugjerojmë se plani i hartuar, duhet të përmbajë edhe një kapitull për menaxhimin e mbetjeve që gjenerojnë gjatë procesit të ndërtimeve, sepse këto mbetje nuk përfundojnë në vend-depozitim e caktuar në Maliq. Ato do të depozitohen e trajtohen brenda territori të bashkisë dhe do të jenë një problem voluminoz, pasi do të ketë ndërtime të reja, riparime e prishje dhe për rrjedhojë do të ketë prodhim mbetjesh ndërtimi.

Detajimi i masave për mbrojtjen e mjedisit:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme.

- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan të hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Bashkia Pogradec, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit, të hartojë një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta dërgojë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor të çdo viti.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të planit.
- Të përgatiten projekte të veçanta për rehabilitimin dhe grumbullimin e mbetjeve, duke përcaktuar disa vende ku do të kryhet depozitimi i mbetjeve në kushte e standarte mjedisore të përputhshme me ligjin për menaxhimin të integruar të mbetjeve.

- Kompostimi i mbetjeve organike të kryhet në nivel fshati apo dy fshatrash. Ky proces të realizohet duke ndërtuar kavaleta e duke kryer një trajtim teknik të tyre, deri në prodhimin e kompostit. Ky do të ishte një aktivitet që do të reduktonte në masën rreth 50% sasinë e mbetjeve të ngurta që do të përfundojnë në vend-depozitim të mbetjeve për rajonin e Korçës, në Maliq.
- Të përgatiten projekte për sipërfaqet e pa rehabilituara, të zëna nga materialet sterile prej aktiviteteve minerare, në zonën Memelisht-Çervenakë - Piskupat. Këto veprimtari kanë dëmtuar rëndë pejzazhin dhe fondin pyjor të zonës së mbrojtur dhe duhet parashikuar rehabilitimi i këtyre zonave.
- Të zbatohen kërkesat në afatet e përcaktuara kohore të legjislacionit të mbetjeve në fuqi, si dhe të bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të instalimeve, në përputhje me për menaxhimin e integruar të mbetjeve, për të bërë të mundur grumbullimin maksimal të diferencuar të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitim në një prej instalimeve më të afërta, të përshtatshme me metodat dhe teknologjitë e nevojshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedisor dhe të mbrojtjes së shëndetit publik.
- Para fillimit të zbatimit të projekteve, të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara në Plan të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture.
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me AKZM-në për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave.
- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve/aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore. Në rastin kur projektet që do zbatohen mund të prekin zona të Mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ujrave, ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “best practices“. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ujë, ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve nën mbrojtje.
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore që gjenden në zonën në studim.
- Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësive së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices“.

- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.

Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarsisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- › Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.
- › Nëse plani nuk është miratuar brënda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëhere deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- › Në rast se ministria, strukturat e saj të varësisë, njësitë e qeverisjes vendore, apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tyre dhe nuk respektojnë kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëhere ministria njofton menjëherë autoritetin përgjegjës për zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kërkon sqarimet përkatëse apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit deri në sqarimin e situatës.
- › Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëhere ministria i kërkon autoritetit miratues e propozues të merren masat e duhura apo të konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standardet mjedisore.
- › Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore.

MINISTËR

Blendi KLOSI